## Korniza ligjore për KLSP-të

Themelimi i KLSP-ve
nga drejtori i përgjithshëm i policisë
rregullohet me nenin 7.5
të Ligjit për policinë.

## Trajnimet për KLSP-të

Trajnime për ndërtim të kapacitetit janë organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe policinë.

Paketa trajnuese përbëhet nga:

Filozofia dhe përfitimet e policimit në bashkësi

Partneriteti dhe ndërtimi i ekipit

Analizimi dhe zgjidhja e problemit

Plani i veprimit të projektit

OSCE
Organization for Security and
Co-operation in Europe
**OSCE Mission in Kosovo**




Anëtaret e KLSP-ve gjate trajnimit për ndërtim te partneriteteve dhe zgjidhje te problemeve

**Komiteti lokal për siguri publike KLSP**



# PARTNERITET
# INTEGRIM
# ZGJIDHJE E PROBLEMIT
# SIGURI



KLSP e ka nisur projektin për ndërtimin e këndit të lojërave për fëmijë në Partesh



Shkallët ne drejtim të shkollës, te ndërtuara me iniciativë të KLSP-ve në fshatin shumetnik të Janjevës (Komuna e Lipjanit)




Anëtaret e KLSP-se në Janjevë duke vendosur kontenierët e mbeturinave në fshat - projekt i përkrahur nga OSBE-ja dhe Komuna

## Çka nënkupton siguria në bashkësi?

Ndjenjën e sigurisë në shtëpi, shkollë, punë apo në rrugë.

Një bashkësi të fuqishme lokale.

Një komunikim të drejtë me policinë dhe me autoritetet lokale.

## Çka është policimi në bashkësi?

Është një mënyrë e përmirësimit të sigurisë në bashkësi.

Nënkupton punën e përbashkët të bashkësisë dhe policisë për t'i identifikuar dhe adresuar çështjet që kanë të bëjnë me krimin, rendin, sigurinë dhe cilësinë e jetës.

Bën thirrje për partneritet në mes të bashkësisë, policisë dhe institucioneve lokale në parandalimin e krimit dhe zgjidhjen e problemit.

## Çka është komiteti lokal për siguri publike (KLSP)?

Është një mekanizëm për t'i zbatuar iniciativat e policimit në bashkësi dhe për të përmirësuar sigurinë në bashkësi.

Bashkon anëtarët e bashkësisë lokale, zyrtarët policorë, zyrtarët lokal, përfaqësuesit e shkollave, gratë dhe të rinjtë të cilët punojnë së bashku në përmirësimin e sigurisë dhe cilësisë të jetës së bashkësisë.

## Si dhe ku janë të themeluara KLSP-të?

KLSP-të janë të themeluara në bashkësitë lokale.

Janë të themeluara nga ana e policisë më kërkesë të bashkësisë lokale.

## Kush mund të jetë anëtarë i KLSP-së?

Çdo person i gatshëm të kontribuojë në të mirë të bashkësisë së tyre dhe të bashkëpunojë më policinë, institucionet komunale, shkollat dhe përfaqësuesit tjerë lokal.

## Si mund të përfitoni ju dhe bashkësia juaj nga puna e juaj si anëtar i KLSP-së?

Ju do të keni një komunikim dhe bashkëpunim më të mirë me policinë.

Ju do të jeni në gjendje të përmirësoni sigurinë dhe kualitetin e jetës tuaj dhe të bashkësisë tuaj.

## Ku mund të gjej më shumë informata për KLSP-të?

Vetëm vizitoni stacionin më të afërt policor apo KLSP-në në rrethin tuaj.